

Mr. Edlira TROPLINI*

DISA TIPARE RUAJTËSE TË ÇAMËRISHTES

E folmja e banorëve të Çamërisë, ose siç njihet ndryshe çamërishtja, ka tërhequr qysh herët vëmendjen e studiuesve më në zë të dialektologjisë dhe të historianëve të gjuhës shqipe, të hulumtuesve të onomastikës shqiptare dhe të folklorit tonë popullor. Të dhënat e asaj të folmeje janë përfillur e përmendur nga gjuhëtarë, folkloristë dhe etnografë të shquar, ndër ta edhe nga prof. Eqrem Çabej. Një punë të vyer dhe me përkushtim të veçantë ka bërë vite më parë prof. Qemal Haxhihasani në studimin e tij të mirënjohur *Vështrim për të folmen e banorëve të Çamërisë*, botuar në serinë "Dialektologjia Shqiptare", vëll. I, II, III, ku ai na ka dhënë një përshkrim të mirëfilltë dhe të hollësishtëm të së folmes çame. Mund të thuhet se ai hodhi në letër atë çka për çamët sot konsiderohet si "thesar" për nga vlera e madhe ruajtëse dialektore dhe etnofolklorike, që paraqitet me një fytyrë të veten, sa të bukur aq edhe interesante për studimet shkencore edhe në ditët e sotme. Me vlerë të madhe është sot edhe kundrimi i kësaj së folmeje në aspektin sociolinguistik.

Popullsia çame është karakterizuar gjithmonë nga një lëvizje demografike e pandërprerë, duke u detyruar të bëjë sidomos lëvizje mekanike e zhvendosje nga vendbanimet e hershme në mjedise të tjera, larg trojeve të veta shqiptare, të mbetura nën Greqinë. Ky ka qenë një problem i rëndësishëm i karakterit politik, jetik e shpirtëror (nënvizojmë këtu edhe lëvizjet e herëpashershme të tyre brendapërbrenda vendit), nga i cili buron edhe shkaku fillestar i shfaqjes së dukurive sociolinguistike si rezultat i të cilave arrihet në një prekje të dukshme të sistemit në të gjitha nivelet në rrjedhë të kohës. Interesi që paraqet e folmja e çamërishtes në përgjithësi,

*Pedagoge në Universitetin "Aleksandër Moisiu" - Durrës.

po dhe e folmja e çamëve të rrethit të Durrësit në veçanti, për sociolinguistikën e sotme është i konsiderueshëm. Pra, nuk bëhet fjalë thjesht për lëvizje gjeografike të cilave ato i janë nënshtruar me forcë apo me dëshirë herë pas here, por për një proces të tërë që lidhet me mënyrën sesi ato integrohen me bashkësitë e vogla mikpritëse, pjesë e të cilave ato janë bërë. Në rastin tonë fjala është për integrim (përfshirje dhe përshtatje) brenda një bashkësie shoqërore durrsake, e cila përkon me qendrën dhe që, në zanafillë, i përket një dialekti tjetër – të folmes së Shqipërisë së Mesme. E folmja çame ka tipare ruajtëse dhe zhvillime e risi me vlera të mira studimore dhe jep dorë mjaft edhe për shqyrtime rreth gjuhëve në kontakt, mundëson për të parë se në çfarë shkalle ka qenë dhe është dygjuhësia dhe gërshetimi etnolinguistik, forca ruajtëse si dhe raportet e tjera dhënëse e marrëse etnolinguistike të një grupi shoqëror të shprishur e të mërguar nga vendi i vet, por që vijojnë të mbahen gjallë e të mos treten për kaq vite me radhë.

Duke pasur si qëllim të nxjerrin në pah, sidomos aspektin ruajtës të kësaj të folure, jemi përpjekur të shohim se çfarë ka ndryshuar tek brezi i vjetër sot. Lënda e parë na vjen nga banorët çamë kudo që gjenden, sepse ato kanë ruajtur dhe ruajnë ende një pasuri të madhe shpirtërore, kulturore dhe një thesar gjuhësor ende të panjohur plotësisht dhe të atillë që u vlen studimeve dialektologjike dhe etnografisë së të folurit të shqipes.

E folmja e çamërishtes karakterizohet nga disa tipare karakteristike, ndër të cilat shquajnë vjetërsia dhe forca ruajtëse e saj, të cilat na japin mundësi të gjera kundrimi, megjithëse kemi të bëjmë me një të folme që i përket dialektit të toskërishtes dhe që qëndron më pranë gjuhës letrare standarde. Në këtë mënyrë, ne kemi mundur të vëzhgojmë të folmen e çamëve të rrethit të Durrësit dhe kemi verifikuar aty të gjitha ato dukuri karakteristike të dialektit të çamërishtes që kanë mbërritur deri në ditët e sotme. Por jo vetëm kaq, nëpërmjet të folmes së brezit të vjetër kemi parë atje edhe se si kanë mbërritur këto dukuri, sa janë ruajtur, por edhe çfarë ka ndryshuar në të folmen e tyre dhe pse. Në një farë mënyre kemi vëzhguar të folmen e brezit të vjetër çam, duke u bazuar në boshtin e trajtimeve që shkon sipas formulës së J. Fishmanit: “*Kush flet, me kë, kur, për çfarë dhe në cilin varietet?*”¹, duke e kompletuar

këtë formulë edhe me tre elemente të tjera të rëndësishme, të cilat shkojnë sipas pyetjeve problemore dhe kyçe për sociolinguistikën: “Si, pse dhe ku?”² Të gjitha këto, ndër të tjera, na çojnë në atë proces mjaft të rëndësishëm për sociolinguistikën e sotme: tek ndryshimi gjuhësor i cili realizohet nëpërmjet marrëdhënieve të ndryshme nga brezi në brez; duke u përshtatur me normat dhe rregullat që vendos një tjetër bashkësi (bashkësia mikpritëse) në të cilën ato janë vendosur; përshtatja me tërë zhvillimin shoqëror në tërësi, me rregullat bashkëkohore të bashkësisë së sotme shqiptare etj. Të gjitha këto shpjen më pas edhe në krijimin e situatave të larmishme sociolinguistike prej të cilave (për këtë të folme) më e rëndësishmja është ajo që njihet tashmë me termin bilinguizmi dialektal.

Këtë gjë e kemi bërë duke hulumtuar tek folësit e kësaj së folmeje nëpërmjet të dhënave të vjela në terren, por duke u mbështetur edhe tek përvoja jonë personale. Fusha e leksikut preket më shumë nga ndryshimet, në sajë të faktorëve jashtëgjuhësorë, që ndër të tjera konsiderohen mjaft të rëndësishëm. Sistemi leksikor

shfaq interes të madh, madje paraqitet me diferencime të dukshme në krahasim me

sistemet e tjera. Megjithatë nuk mohojmë dot faktin që edhe sistemet e tjera janë të prekshme dhe me interes për t’u shqyrtuar.

1. Ruajtjet në fushën leksikore janë shumë më të mëdha e të dukshme në brezin e vjetër. Ato sigurisht vijnë duke u pakësuar në brezat më të rinj. Vihen re konkretisht disa emra të lidhjeve farefisnore, disa huazime, emra nga fusha e gatimit, emra bimësh aromatike; disa emra topikë, antroponimikë, patronimikë etj. P.sh: *kallmar* (lloj ëmbëlsire, në shije e ngjashme me bakllavanë), *qahi* (byrek me djathë), *bazi* (kaçamak); *skaminë* (mana), *purtek* (thupër me të cilën rrihet kafsha), *mirgale* (bajame, në disa zona përdoret edhe fjala *mingladhë*), *llapsana* (barishte të egra që përdoren edhe për të ngrënë), *cukunidha* (hithra), *maraj* (kopër); *tumane* (brekushe), *konoxhup* (pallto e trashë për dimër); *xhixho* (xhaxha), *xhexhé* (xhaxheshë), *nu* (nënë, por për më të rinjtë në moshë fjala ka marë edhe kuptime të tjera), *dajkël* (nuse e dajës), *thapë* (thonj), *koca* (gërshet), *çeç* (vëllai i madh), *kumbi* (kopsë), *qomstek* (orë xhepi), *stromë* (dyshek), *papllomë* (jorgan), *sinì* (tepsi e madhe bakri e cekët), *pirosti* (mbajtëse e enëve në zjarr), *ikua* (vendi ku

stivohen jorganët, dyshekët), *cimidh* (mashë), *sinor* (kufi), *vorua* (oborr), *çapele* (fiq të thatë), *karkanaqe* (lloj ëmbëlsire e ngjashme me gurabijet), *kukulle* (bukë misri, por që ndryshon me këtë të fundit pak në gatim), *bòkall* (fik i papjekur), *dhilì* (të fikët), *kalistir* (kep, vegël pune që prashit), *foti* (kandil) etj.

Gjatë ligjërimin të folësve të ndryshëm kemi vënë re edhe zëvendësimin e fjalëve të dialektit çam me fjalë të shqipës së përgjithshme, duke i konsideruar të parat si të vjetruara. Edhe ky është një proces që nis me brezin e vjetër dhe vazhdon me hapa më të shpejta në brezat më të rinj. Me pak fjalë, sikurse do të arrijmë në këto përfundime edhe për dy fushat e tjera (fonetikë, morfologji), këtu na tërheq vëmendjen ajo dukuri, që e përmendëm më lart dhe që sot është mjaft e diskutueshme, bilinguizmi dialektal. Shembujt për këtë janë të panumërt, mjafton të kujtojmë vetë kontekstin në të cilin kësaj të folmeje i është dashur të mbijetojë. Ja disa shembuj interesantë të dygjuhësisë në të folur:

I thomi katua bodrumit neve (katua-bodrum); *Atje bëmë çadre me velënxa*, - i thomi ne, *ju i thoni batanije*, *po ne i thoshim velënxa leshi* (velënxa- batanije, normalisht fjala velënxë nuk përkon me fjalën batanije, por nuk duhet të harrojmë që kemi të bëjmë me folës të paarsimuar mirë); *Do t' vesh* me këtë, *a do viç* me mua (vesh-vish <viç- aoristi sigmatik); *E* (edhe) *kutu tani t'vesh gjakundi humb mënen* (mëndjen) *e kokës*; *Se e mba mend* / *se kam ikur dhjetë vjeçe* (nd>d); Madje ndodh që folësi ndonjëherë edhe ngatërrohet: *Përpara visheshin me dimiq* (e folmja e Shqipërisë së mesme), *ju i thoni tumane* (e folmja çame); *dimiq/ tumane- çitjane*.

2. Në të folmen e çamëve të rrethit të Durrësit, na tërheqin vëmendjen disa elemente ligjërimore në sistemin fonetik të saj, të cilat spikasin për veçanësinë e tyre dhe shërbejnë si shenjues të rëndësishëm të origjinës çame. Ato janë pjesë e fizionomisë së bukur të këtij dialekti, disa prej të cilave i ndeshim jo vetëm në brezin e vjetër, por edhe në brezat aktivë, madje edhe në të folurit e më të rinjve, tek të cilët ruhet ende një "ngjyresë" a timbër i çamërishtes.

2.1. Nga një studim i hollësishëm dialektologjik që kemi bërë tek e folmja çame sot, nëpërmjet hulumtimit të së folmes në brezin e vjetër, një nga veçoritë fonetike që na ka bërë më tepër përshtypje në sistemin e zanoreve, është mënyra e veçantë e theksimit të disa fjalëve.

a. Theksi logjik

Për herë të parë, dukuria në fjalë është trajtuar nga Qemal Haxhihasani. Ai e emërton këtë dukuri me termin theks sintaktik. Shprehimisht ai thotë: “Rrokja e fundit në fjalitë pyetëse merr në këtë të folme një farë gjatësie, ngjyre dhe ngritje të veçantë zëri... Në raste të tjera fjala merr dy theksime të njëpasnjëshme, duke arritur pikën më të lartë të ngritjes së zërit në rrokjen fundore. Një ngjyrë, gjatësi dhe ngritje të tillë të zërit merr rrokja fundore edhe te plotësi thirrur, në çdo pozicion që të jetë ky”³. Ajo që Haxhihasani ka konstatuar duket plotësisht e drejtë. Fatmirësisht këtë gjë e vërteton më së miri edhe e folmja e brezit të vjetër sot. Ndër të tjera mendojmë se kjo është një ndër dukuritë më të rëndësishme të së folmes së çamërishtes, pasi mbart një tërësi elementesh të cilat përbëjnë një dukuri të vetme. Jo vetëm kaq, por ne shtojmë në përshkrimin e saj disa të dhëna që ndoshta ndihmojnë në një të kuptuar më të mirë. P.sh. megjithëse është rrokja e fundit ajo e cila përcjell ngjyresën e bukur të këtij theksi, mendojmë se kemi të bëjmë me një kombinim veçorish në tërësi: të theksit të fjalisë, të intonacionit të saj, timbrit të veçantë të zërit, si dhe zgjatja e zanores në rrokjen e theksuar që përkon me rrokjen fundore të fjalës, duke e shqiptuar gjithmonë me një ton më të lartë se në fjalët e tjera dhe asnjëherë me ton të ulët (që është më e rëndësishmja). Nga të dhënat tona shohim që ky është një theks karakteristik jo vetëm për fjalitë pyetëse, por edhe për lloje të tjera fjalish, jo vetëm tek thirrori por edhe në gjymtyrë të tjera. Nëse kemi të bëjmë me fjali pyetëse, ato në të shumtën e rasteve mbartin edhe nuanca të tjera plotësuese përkatësisht: habi, dëshirë, urdhër etj. Në këtë këndvështrim duket sikur dalim jashtë caqeve të përkufizimit të këtij theksi e megjithatë nuk mund ta emërtojmë ndryshe këtë dukuri.

Të gjitha elementet përbërëse të saj nuk mund të shihen veçmas, por në kompleks me njëri-tjetrin. Për të dhënë një përshkrim sa më të qartë dhe bindës, po japim disa shembuj:

nan mo:j / sado/ nan isht Po ç i jetë isht kijo nus’ e Petrîtît Çish do flas tânjâ?/kur kem ardhur kêtëj/ kur kem ikur âtëj/ n’çi vî:t?/çi thôtë? Po ti qe njëzet e ca vjeç mo bàbë? Po merre e ti njw? S’erdh

nònji a erdh *nònji*? E ka marrë nusen ki i vogli i *Bashkimit*, ç'ish do flas *tàni*? n'çi *vì:t*? Ç'i *thòtë*? Se ish behar *ò:j*? Ç'u *èrrë*? Ç'u *dìvë*? Thuaj dhe ktë ti plak? Pësaj në çish sene, muaj i solli *bùrrat*? Tashi/n'Çàmëri?.../jo, *mò:j*/çi i *strehòjë:m* ?; ka gjenda *ekonomikë*? Lekët na mbenë atje neve *mò:j*. Do të Greqisë *tì:/ç'i* i ka thertur *çàmtë*? Ç'i i ke *djè:lt*? etj.⁴

b. Sot, në të folmen çame, është vënë re që ruhen ende fjalë tek të cilat theksi bie në rrokjen e parë. Kryesisht këtu spikasin përemrat dëftorë dhe disa ndajfolje me theks parafundor që gati në mbarë toskërishten dalin me theks fundor (oksiton). P.sh: *àjo, àj(i), àtej, tàni, tànja, kùtu, kùvo, àt* etj. *nuku e kish vajz në pashaportë àjo; kùtu/e kemi kùtu djalin; i çoi àtej ka kufiri turk/mori àta pleq/në muajin Maj u lëruan kùto.. tàn-ja si në kët kehe e mba mënd; edhe veshjen/àt veshje që bëjmë àtje /àtë veshje kemi edhe kùtu; do iki kùjo tàni; po kùtu tani u përzien; që e mori gregu àt pjesë/ kùjo jota/ kùjo ima etj.*

-Duke bërë krahasimin e çamërishtes së sotme të vjetër me çamërishten tradicionale, (dialektin e vjetër çam) vërejmë se shumë fjalë tek të cilat ishte i pranishëm theksi nistor, ose kanë marrë theksim si në mbarë shqipen, ose kanë pësuar "rrafshim" me të folmen e Durrësit (përderisa kemi marrë si shembull kryesisht të folmen e çamëve të ngjuar në rrethin e Durrësit), pra janë bjerrur plotësisht si fjalë të vjetruara dhe nuk kanë mbërritur deri më ditët e sotme.

-Kanë pasur theks parafundor dikur: disa fjalë që ndiheshin si oksitone: *fàrmëk, ròdhez, màngan, kùel, këleme, dhòkan*; disa emra që mbarojnë me **-all**: *çàkall, çàqale, bòkall, bòkale, dhàskall, gràvall, gràvale etj*; disa emra topikë si: *Prèveza, Jànjari, Vràstava, Spàtari, Shqëfari etj*; patronimet që mbarojnë me **-anj**: *Kùrtanj, Hùsanj, Vèlanj, Rùsanj, Mànanj etj*. Nga të gjithë këta shembuj, vetëm fjalët *kùel, spàtari, Shqëfari* shqiptohen si në çamërishten e moçme. Dukuria në fjalë shfaqet e pastër vetëm tek përemrat dhe ndajfoljet, megjithëse nga sa na rezulton nga të dhënat e mbledhura në terren, shenja bjerrjeje vërejmë edhe brenda këtyre kategorive.

c. Si një e folme e vjetër me karakter ruajtës, çamërishtja karakterizohet nga disa huazime, të cilat janë bërë pjesë e kësaj të folmeje nga kontaktet e saj me gjuhë të tjera, konkretisht turqishtja dhe greqishtja. Kontakti me turqishten i përket së njëjtës periudhë

historike të mbarë shqipes, por me një ndryshim të madh, që ruajtjet e këtyre huazimeve tek kjo e folme për shkak të afërsisë gjeografike me etnikumin grek, paraqiten shumë herë më të mëdha sesa ato në shqipen e sotme. Ndërsa kontaktit të saj me greqishten i referohemi shumë vonë. Pra, periudhat kohore të depërtimit të huazimeve brenda kësaj të folmeje janë të ndryshme. Megjithëse çamët e vjetër i janë nënshtruar me kohë edhe një lloj kontakti tjetër, konkretisht atij me shqipen e evoluar dhe për më tepër me të folme të ndryshme të bashkësive të vogla, (sipas zonave që ato janë vendosur: në rastin tonë nëndialektit të gegërishtes jugore, të folmes së Shqipërisë së Mesme); përsëri në repertorin e tyre do të bëjnë pjesë një tërësi fjalësh të këtij lloji të ruajtura mjaft mirë.

- Spikasin konkretisht fjalë të shqiptuara me theks fundor si: *evli, vëllahì, sitaxhè, teshqerè, kāvè, qōshè, qīblè, gjulè, xhēzvè, bākshè, hīsè, sēftè, çiftè, parà, sufrà, llapà, mashà, kazmà, misìr, bakùrr, eksorì, jabanxhì* etj.

Fton burri me këso/ me *tesxerè*; galorë të tërë me kual me *sitaxhè* të shtruar; hem *jabanjxhì* / hem me bagti; ka shtatmjet vjeç e deri në gjazhdhjet vjeç i mori *eksorì* burrat; zulluhi e madhe/ ù ish *evli*.

-Kjo dukuri vihet re edhe tek disa antroponime që theksohen në fund, të cilat ndër të tjera janë edhe dëshmi e besimit fetar që çamët praktikonin dhe praktikojnë akoma edhe sot e kësaj dite, p.sh: *Nailè, Esmà, Hasimè, Habìb, Shabanè, Bahjè, Hidajèt, Sadàt, Ahmèt, Ramadàn* etj.

- Me të njëjtin theks shqiptohen edhe disa fjalë nga fusha e gatimit: *fāhì, musakà, bakllahì, hallvò, paçà, revanì, qahì* etj.

- Ndërsa, po të analizojmë një dukuri tjetër mjaft interesante të këtij dialekti, siç është ajo e ruajtjes së theksit në rrokjen e parë të fjalëve (kryesisht tek përemrat dëftorë dhe ndajfoljet), të cilat sot theksohen në rrokjen e fundit, arrijmë në të tjera përfundime: megjithëse tek brezi i vjetër kjo dukuri shfaqet e qëndrueshme, përsëri rastet e prekjes së saj nuk mungojnë gjatë të folmes. Shpeshherë vërejmë përdorime bilinge, që siç do ta shohim nuk janë karakteristike vetëm për këtë rast, p.sh: *E more vesh tani, kur qepeshim ne(të) ajo vī:la:?* Ja thonë një fshati ninat *atjè*; ndenjëm njëzet dit *atjè/kshu tavani*; do marri malli e *kùtu...* saa kur ishën *atje*/këndojn edhe zojt e turkut/i ndijën *kàvta* atje; Po ooo.. me kristjanë s'kish gjë me kristjanë /ai e kish me ne; *kjo* isht vajza jote nus' e Petrìtit? Nga Kavaja erdhëm *ktu*

pësaj; na lanë àtje ato/erdhëm me kuel rrugës/ ngarkuar me plaçkë ...

Pra, megjithëse tek moshat më të vjetra vihet re një farë mbyllje në vetvete që ka lidhje me konservacionin e ndërgegjshëm, i cili nuk favorizon ndryshim brenda të folmes, rastet e dyfishta të përdorimit të dukurive të ndryshme, dysorësia në të folur, bjerrja apo futja e elementeve të reja, vërtetojnë të kundërtën. Ndryshimi në rastin tonë është i dyanshëm. Ai ndodh si nga ndikimi i së folmes çame nga ajo geqe e Durrësit, ashtu edhe sipas shqipes së sotme të përgjithshme.

d. Nga kundrimi dialektologjik në të folmen çame, vërejmë që në të ruhen ende zanoret e gjata. Të folmet që e ruajnë këtë dukuri janë shumë të rralla. Konkretisht, ruajtjen e zanoreve të gjata e gjejmë ende në ato të folme që paraqesin afri me çamërishten, siç janë disa zona të izoluar të toskërishtes, labërishtja, gjuha e arbëreshëve etj. P.sh, arbëreshët e Italisë sot në ditët tona fjalën *det* e shqiptojnë *deet*⁵ Ruajtja e zanoreve të gjata, e kushtëzuar nga rrethana të ndryshme fonetike, dëshmon edhe një herë për atë faktor mjaft të rëndësishëm të historisë së gjuhës sonë shqipe, afrinë midis dialekteve tona dikur në kohë të hershme.

- Zanoret e gjata përkojnë në këtë të folme me zanoret e theksuara, sipas disa pozicioneve të caktuara në të cilat bie edhe theksi i fjalës. Kështu si zanore të gjata na shfaqen: zanoret e theksuara në rrokje fundore të hapura, gjatësia e të cilave ruhet edhe kur ato marrin trajtat e shumësit; zanoret e theksuara përpara bashkëtingëlloreve lëngëtore *-r, -l, -ll*; zanoret e theksuara në rrokje të mbyllura ose të hapura para bashkëtingëlloresh të tjera, sidomos para dhëmboreve dhe hundoreve; zanoret e gjata të cilat përkojnë me zanoret e theksuara në trajtat foljore të aoristit sigmatik, në rrokje të mbyllura; zanoret e theksuara në vetën e tretë shumës të së pakryerës së disa foljeve ku kanë ndodhur ç' rregullime të ndryshme; zanoret e gjata në trajta të ndryshme foljore dhe emërore të përfutuara nga dukuri të ndryshme fonetike, konkretisht rënie e asimilime fonemash. Ja disa shembuj për secilin rast:

p.sh: ...ka shtatëmbëdhjetë e rëpjetë i mblodhi eksorī, ... edhe Habibi pësaj se dëroi, u ngrë/ e bëri bolorī ...sī të(sytë) mbëluar deri këtu(tregon me gjeste)/vajzat ;

joo...mīr u kish sēllë/ me greg u kish sēllë mīrë; kemi shkuar njëmīlë halle rruguve; mbēmë që nātanë llogarait// rāmë në një fshat; jo i thāç ù/

do t'jā:pç karar..; dot'vëshme kët/aa do vīç, me mua;që të na zāpojnë vënin...; ...edhe kalamajt në lum i hīdhën moj të keqen..;); .. ikëm vāmë në Ninat.../ gem të zōt'e vetes vetë neve; ..ja / vāte një moshatarja ime // me kacolle/ me kāsht ishin.....

Të gjitha këto dukuri fonetike nuk janë asgjë tjetër veçse dëshmi e ruajtjeve të zanoreve të gjata në brezin e vjetër, ende në ditët e sotme.

e. Një tipar dallues ndërmjet toskërishtes dhe gegërishtes është kalimi i -a-së hundore geqe në -ë të theksuar të toskërishtes.

- Për këtë të folme na kanë tërhequr vëmendjen disa fjalë të veçanta, tek të cilat *-a-ja* e theksuar ka mbetur e pandryshuar, p.sh. në fjalët, *tumane*, *nanë*, *havan*, *pelivan*, konkretisht në disa antroponime si, *Sulejman*, *Osman* etj. *Nanë moj/ sado nanë isht..; këtej na krehin nanatë/ këtej vuuu...morri...*

Shembuj të tillë flasin qartë për zhvillimin e vonshëm të dukurisë së shndërrimit të *-a-së* theksuar në *-ë*, për rrjedhojë për përbashkësinë e dialekteve tona në kohë të hershme.

-Karakteristike për këtë të folme është përdorimi i veçantë i foljes *běj*. Tek kjo folje *-ë-ja* e theksuar, përveçse është përftuar nga një *-a* e theksuar, ka pësuar zhvillime të mëtejshme, ajo ka evoluar në *-i*, në disa raste të veçanta edhe në *-u*. Këto folje përdoren në kohë dhe modalitete të ndryshme: *bij*, *bijmë*, *bim*, *bijnë*, *bija*, *bije*, *bin*, *bijmë*, *binit*, *bijnë*, *të bij*, *të bish(biç)*, *të bijë*, *të bimë*, *të binë*, *të bijnë*, etj.

-Ndonjëherë spikasin edhe forma të tilla më të vjetra si: *bijëm*, *bijët*, *bijën*, / *të bijëm*, *të bijët*, *të bijën*, etj ,të cilat përkojnë me faza të kapërcyera të gjuhës shqipe. P.sh: *bijën pun kshu..nëpër punëra me kazma..; ç' të biç/ nëntë fëmilë/ t' shkojm t'bijm shkollë..; i bijim si çimento dhe i lyejtim ato...; na binte gregu/ na therte...; s'keshëm ku t'i bijim/çelim furrën e bijëm bukë/ bijëm bukë e vitit//*

-Në të kryerën e thjeshtë dhe në dëshirore vërejmë tek kjo folje edhe kalimin e *-ë-së* në *-u* p.sh, *bura*, *bure*, *huri*, *bumë*, *butë*, *bunë/ bufsha*, *bufsh*, *buftë*, *bufshim*, *bufshit*, *bufshin*: *bum ktë copëzë shtëpi/ u bu shpirtmirë një....*

-Një folje tjetër që na tërheq vëmendjen dhe që meriton të trajtohet në veçanti përkrah foljes *běj*, në kuadrin e *-ë-së* në *-i*, është dhe veta e tretë njëjës e së tashmes së dëftores së foljes *jam* (isht). P.sh : *histori e çamërisë kjo isht..; epo ja!- në ndjekje isht ajo punë...*

f. Përkrah dukurive të tjera karakteristike të çamërishtes, është edhe mungesa e zanores *-y* në sistemin e saj fonetik. Ajo zëvendësohet me zanoren *-i* në këtë të folme, p.sh: *çish, ki, iti, ini, ti, di, dizet, si, qitet, diqan, disheme, mbitem, mbillem*, etj. Në tetor të dizetësë filloi lufta itallo-greke..., dënjën nja *di tre vjet sa i gënjen/sa i futën bërna i oranë ata; të gjithë me shpia dikaçe .../n'at qitet qi t' thash* *ù ti*.

- Në të folmen e brezit të vjetër, tek fjalët me prejardhje turke zanorja *-y* zëvendësohet me zanoren *-u*. Duke pasur parasysh që kjo dukuri gjendet edhe tek disa fjalë të tjera të fondit të shqipes, mendojmë se në rastin e fundit mund të ketë vepruar edhe analogjia; për më tepër edhe këtu vërejmë që herë pas here vepron dysorësia në përdorim. P.sh: *...epo mirë shuqur / umur të na kenë ; na ra dushemeja në kokë..; ajo ish pesëqind metra e gjatë dhe duzet metra e gjerë..; baba im hapi duqan/ në dark e billëm duqanin...; për inat grekve thjeu atë/ ..dishemenë...deri n'nji t' natës diqenet hapur ...; keshëm dizet dilim tokë..; isht bën me undirë shumë..etj.*

-Mungesa e zanores *-y* vërehet gjithashtu mjaft mirë edhe tek të folme të ndryshme të arbëreshëve të Italisë. Lidhur me këtë dukuri një punim të posaçëm dhe përgjithësues për të gjithë arbëreshët e Italisë ka bërë M. La Piana, në vitin 1949, i cili në veçanti ka studiuar të folmen e arbëreshëve të Sicilisë. Edhe sot e kësaj dite tek arbëreshët e brezit të vjetër, fjalë të tilla si, *sy, dyllë, dy* etj, shqiptohen: *si, dillë, di* etj.

g. Tek e folmja e brezit të vjetër ruhet mjaft mirë edhe dukuria e shndërrimit të *-u*-së së patheksuar në *-ë*: *Pënoj, këptoj, dëroj, mbëloj, rregëlloj, pëshoj*. Psh: *edhe Habibi pësaj se dëroi...; pënojëm moj ktu/ku kishim lekë ne...; ...vineshin të mbëluara ..., ...; ...pshëmull, që mbjellin duhan tokat kutu..., ...atje na u sumur baba neve..., ...na thotë ai mususi/ na foli grekçe...etj.*

2.2. Togjet zanore dhe diftongjet

Ndër diftongjet që spikasin më tepër tek e folmja e kësaj zone janë:

a. diftongjet zbritës *aj, oi*, të cilët përdoren zakonisht tek foljet në përgjithësi, si dhe tek përemri *ài*, p.sh: *edhe ài iku që àt dit/ a mnesmet nuk e di...; mbenë këta/ i lajmë / i rrijmë/ i shplajmë ...;.. edhe Habibi pësaj se dëroi...;.. jermani na shpëtoi neve .*

b. diftongu ngjitës *ie*, përdoret gjithmonë tek folja *pyes* sipas kohëve dhe mënyrave të ndryshme, p.sh: *...do t'pies m'tha mua...; ...n'at kohë s'piesëm uj t'mirë/uj t'keq...; . Nuk mund të anashkalojmë faktin që me ndryshimin e kohës së foljeve është vënë re edhe një përdorim dyfish i grupit *ie* jo vetëm si diftong ngjitës (*bieç, zieç, ziejmë, përziejmë* etj.), por edhe si tog zanor (*bie, ziej, përziej* etj.)*

2.3. Bashkëtingëlloret

a. Në sistemin bashkëtingëllor spikasin një grup fjalësh të cilat ruajnë ende *-l-*në e vjetër ndërzanore, e cila në gjuhën shqipe ka përfunduar në *j*.

Kështu na tërheqin vëmendjen fjalë të tilla si: *fëmilë* (fëmijë), *bilë* (bijë), *kuel* (kuaj), *rrumulë* (rrëmujë), *milë* (mijë), *palë* (pajë), *valë* (vajë), *golë* (gojë) etj., P.sh: *Po ç'i jetë isht kijo nus' e Petritit/ fëmilë e ndarë /shtëpia ka shtëpia; vjen non jherë i shoqi i sat bile?;... vargan/ armë /kuel /Allah/ rrumulë// .. ja / tan-ja si n'kët kehe e mba mënd/ kemi shkuar njëmilë halle.*

-Tek përfaqësuesit më të vjetër të këtij brezi, ndonëse në raste të rralla, vihet re përdorimi i kësaj dukurie edhe tek shumësi i emrave mashkullorë që në njëjës in e pashquar dalin me *ll*, si dhe tek disa prapashitesa emrash foljorë ose jofoljorë. P.sh, *kokall- kokale, hell-hele, kërcell- kërcelë, lëngëla, priftëla, ngordhëla, bishtëla* etj.

-Përveç zhvillimit të kësaj dukurie në fjalë të fondit leksikor çam, vërejmë edhe disa përdorime analogjike në fjalë të tilla si: *daule, portokale* etj.

-Dukuria e ruajtjes së *-l-*së së vjetër vihet re shumë qartë edhe tek të folmet e

arbëreshëve të Italisë, në përdorim e sipër edhe sot e kësaj dite, kryesisht në fjalë të tilla të ngjashme me ato të çamërishtes së sotme, si: *vaj- valë, pajë- palë* etj.

Edhe kjo është një dukuri e cila dëshmon atë të vërtetë të pashmangshme tashmë, përbashkësinë e dialekteve tona në kohë të hershme.

E megjithatë, ndryshimi në lidhje me këtë dukuri do të vihet re edhe tek brezi i vjetër. Kështu tek e njëjta folëse, përgjatë së njëjtës ligjëratë, hasim edhe përpjekjet e saj për t'i përdorur siç duhet fjalët e mësipërme: *...në fillim këta na mbrojn fëmijt/ që t'kalojn fëmijt dhe gretë..*Kjo gjë shpjegon më së miri edhe faktin tjetër, pse nuk gjejmë

asnjë gjurmë të kësaj dukurie në brezat pasardhës.

b. Një tjetër dukuri tipike në sistemin bashkëtingëllor të fonemave, është edhe ruajtja e togjeve bashkëtingëllore *kl*, *gl* kryesisht në fjalë të tilla si: *kle- qe* (ishte), *kleçë- qeshë*, *glisht- gisht*, *glishtër- gishtëz*, *klumusht- qumësht*, *klumushtuar- qumështor*, *kliçe* (kyçe), *klafë* (qafë), *gregli* (greqi> grekli> gregli), *glëmbi* (gjëmbi), *shklata* (shkle ata), *i shklier* (i shqyer), *shklarë* (i shqarë- i shkarë), *klishë* (qishë-kishë), *zglidh*(*zgjidh*>*zgidh*) etj.

-Edhe ruajtja e këtyre togjeve vihet re tek arbëreshët e Italisë. I pari që e ka konfirmuar këtë ka qenë Solano, më 1979, i cili në tri bashkësitë arbëreshe të Sicilisë; në pesë bashkësitë e Katanxarës dhe pesë bashkësitë arbëreshe të provincës së Potencës, ai spikat pikërisht ruajtjen e togjeve të vjetra bashkëtingëllore *kl*, *gl*, *pl*, *bl*, *fl*. Këtë dukuri të rëndësishme e gjejmë edhe në librin e parë të letërsisë shqiptare, tek "*Meshari*" i Gjon Buzukut: *...se gluha jonë nukë kish gjā të ndigluom....u lus mbas sodi mā shpesh të uini m klishë..etj*

c. Si të gjitha të folmet e tjera të toskërishtes edhe e folmja e çamëve të rrethit të Durrësit ka karakteristikë rotacizmin, tipar ky dallues i rëndësishëm për dy dialektet e shqipes. Në të folmen e çamëve të vjetër, kemi parë edhe disa raste të veçanta në të cilat fonema *n* qëndron e parotacizuar. Kjo vihet re sidomos tek pjesorja e foljes *bëj*. P.sh: *ja / këtë bëni ai*; *nu na lanë gjë pa bën*; *ja / si bënen kutu /bënen e atje*. Verifikimi i kësaj ruajtje sot dëshmon edhe një herë atë fakt të rëndësishëm të zhvillimit të dukurisë së rotacizmit mjaft vonë në të folmen e toskërishtes.

d. Në këtë të folme në sistemin e fonemave bashkëtingëllore, na bën përshtypje edhe një dukuri tjetër mjaft interesante, këmbimi i fonemave bashkëtingëllore. Pra, një fonemë këmbëhet me një tjetër në mënyrë të kushtëzuar ose jo, p.sh: *ka* (nga), *kado* (ngado), *Krikohuar* (Grikohuar), *kaqë* (ngaqë), *greg* (greg) etj; *atej* (andej), *kālive* (kolibe); *vaht* (vakt) etj

- Edhe bashkëtingëllorja *nj* në përgjithësi paraqitet e qëndrueshme, megjithëse tek brezi i vjetër çam sot vërejmë ndonjëherë shqiptimin e saj në dy forma: e para, - *nj-ja* zberthehet në *n+j*, p.sh: *çdon- jeri*, *n-jonjherë*, *tan-ja*, *n-jaj etj*; e dyta, *nj>j*, sidomos tek foljet, p.sh: *ndëjëm*, *pënojëm*, *kalojëm*, *prodhojën*, *të zij*, *të bij*, *të lijn*, *dëjëm*, etj.

-Nga krahasimi i çamërishtes tradicionale me të folmen e çamërishtes sot, vërejmë që disa këmbime nuk kanë mundur t'i rezistojnë kohës. Sipas Qemal Haxhihasanit dikur *q-ja* nistore është sonorizuar në *gj*; *-q-ja* para bashkëtingëlloreve *t, n, m, r* dikur kthehej në *j*: *i pajtë, mijtë, fijtë, plejtë, hojnë, dojnë, vdijnë, u përpojme, u dojç, u përpojç* etj. Nga këto dukuri dhe të tjera si këto, ndonjë përdorim i rrallë në mosha shumë të vjetra edhe do të vërehet, siç ndodh p.sh. me qiellzoren e zëshme *gj*, e cila në disa fjalë është kthyer në *j*, p.sh: *kallojer, jerman*, etj, megjithëse në përgjithësi këto konsiderohen dukuri që janë bjerrë.

3. Morfologji

3.1. Edhe sistemi morfologjik paraqet larmi interesash për këtë të folme. Veçanërisht për emrin spikasin këto dukuri:

a. Për shembull, shohim që gjejnë ende përdorim një pakicë fjalësh të gjinisë asnjane, konkretisht në shprehje të tipit: *ç'më ngjeth misht; vdiqa ka të ftohtët; plasi ka të klarët; i bëri të bardhët e vesë* etj. Shembuj të tillë janë dëshmi e plotë e pranisë së kësaj gjinie në ditët e sotme;

b. Emrat femërorë që në njëjës in e pashquar dalin më *e*, kur shquhen e humbasin zanoren *-e* të nyjës së sprasme: *nuse-nusa, dele- dela, lule- lula, mace- maca*.

- Ky rregull vlen më tepër për emra femërorë me theks parafundor, ndërsa, tek disa emra të përveçëm me theks fundor nyja do të ruhet, p.sh: *Gjule- Gjulea, Fatime- Fatimea* etj.

c. Formimi i shumësit të emrave pak a shumë është i ngjashëm me atë të mbarë shqipes së sotme. Për emrat në gjininë mashkullore spikat më tepër shumësi me metafoninë e *-a-*së së theksuar të rrënjës, p.sh: *duqan-duqene, çoban-çobenë, djalë-djel, plak-pleq, kokal-kokele* (por edhe kòkale), *çurap-çurepe* (por edhe çurape) etj.

d. Ndër trajtat më të rëndësishme rasore në brezin e vjetër konsiderohen mbaresat e rasës kallëzore.

- Emrat mashkullorë që në të pashquarën e njëjësit mbarojnë me zanore, e formojnë të shquarën e kallëzores nga trajta e pashquar e kësaj rase me mbaresën *-në/-n*, p.sh: *mullinë, sinë, pënë, sufranë, kruan, ftuan, zanatçinë* etj. *mazah se bën këg njëjë; ne shtrojmë sufranë që hajëm bukë...; i qërroi greku sinë* pjesaj etj.

- Emrat mashkullorë që mbarojnë me bashkëtingëllore, e formojnë trajtën e shquar të kallëzores sikurse në mbarë shqipen e sotme. Lidhur me këtë, bëjnë përjashtim disa trajta të pranishme pa zanoren *i*. Ato dalin njëlloj me mbaresën *-në*, por të shoqëruara nga fenomene të ndryshme fonetike, psh: *fshanë, baragnë, surranë, pallanë, varrë, djalë*, etj. Në brezin e vjetër sot ky përdorim zë vendin më të madh.

3.2. Ndër llojet e përemrave që spikasin më tepër, janë:

a. Përemri vetor, tek i cili do të vërejmë disa veçori: e para, ka të bëjë me vetën e parë njëjës të këtij përemri **unë**, i cili në emërore del në formën e tij të thjeshtuar, në trajtën arkaike **-û**. Ky përdorim ka qenë i pranishëm pothuajse në të gjithë shembujt e trajtuar deri tani, çka vërteton praninë e padiskutueshme të kësaj dukurie në ditët tona. Nuk mund të lëmë pa përmendur shpjegimin që gramatika historike i bën këtij përemri, sipas së cilës, forma e hershme **-û** e ka prejardhjen nga një vetor **"swe"** të indoevropianishtes. Siç është konfirmuar nga studiuesit, por edhe nga dhënat tona, kjo formë përkon me fazat më të hershme të shqipes. Si dokument për këtë, shërben libri i parë në gjuhën shqipe **"Meshari"** i Gon Buzukut, tek i cili shohim praninë e kësaj forme që në hyrje të tekstit. **Û Doni Gjoni, biri i Bdek Buzukut... etj.**

Duke shkuar më tej, këtë trajtë e gjejmë edhe tek disa të folme të tjera, si p.sh. tek të folmet arbëreshe, apo tek disa të folme të anëve të Tiranës, si dhe në disa dialekte ekstreme të Veriut, apo të Malësisë së madhe.¹

Tashmë japim disa shembuj konkretë të këtij përdorimi: *û të kam si vajzat e mia tashi; ..û kam qënë nxënës shkolle n'atë kohë; Shkoi n'at fshat q'thom û / n'Dragoj etj.*

Megjithëse kjo lloj dukurie shfaqet natyrshëm dhe mjaft shpesh, nuk mungojnë në këtë të folme, megjithëse rrallë, edhe rastet e shfaqjes së formës së rregullt të saj (*unë*) që përkon me shqipen: *...unë n'fshat t'Kurtesës kam lindur/un.....*

b. Për përemrat **dëftorë** sikurse tek vetori, në të folmen e brezit të vjetër vërejmë larmi përdorimesh, konkretisht: përdorime të ndryshme të formave të rregullta të këtyre përemrave; forma të hershme të përemrit dëftor; forma me dallime të ndryshme të karakterit fonetik, përemra dëftorë në funksion të mbiemrit etj. P.sh: *ki (ky), kijo(kjo), këta, këto, kta, kto, këtitë, këtiya, atitë,*

atija, këture, kuture, këtire, atyre, atire, ature, këso, aso etj.
qepeshim ne (tek) ajo vila; ç'janë këto me rroba t'zeza...; ...na thotë ai mususi nevet/ vate në fshatin tonë kjo vajzë; ... do të iki kijo tani (kijo/këjo- trajtë e hershme). ...; të thoshte hëngri kijo s'më fliti mua ; fton burri me këso...me tesxere.etj.

c. Edhe tek përemri pronor shohim forma të larmishme të shkaktuara nga dukuri të ndryshme fonetike mjaft tërheqëse për dëgjuesin, p.sh: *inë* (ynë), *it* (yt), *i tire* (i tyre), *i ture* (i tyre), *ima* (imja), *jota* (jotja) Edhe këtu vërejmë atë dukuri fort të spikatur tashmë, të dysorësisë në përdorim, p.sh: *...nëna ime thoshte .; jo kjo toka jote / jo kjo toka ime //kijo jota/ kijo ima..*

d. Për përemrin pyetës, dy janë ato që na tërheqin vëmendjen më tepër: *ç* dhe *çish*. Një tjetër element është edhe lokucioni *me se* (parafjalë+ përemër, se= çfarë), që vihet re dendur në ligjërimin e tyre. P.sh: *ç'rënd të kam/ i tha ...; çish thatë? Po ç'i jetë isht kijo? ...marrim këtë ç'i thonë...; ...çish veni/ si jeni...// çish do vemi/ i tha baba...; Me se do i bini? Me se do jetoni? Me se e do bükënë?: Me se d'e mârri:sh?*

Siç e shohim edhe nga larmishmëria në përdorim të formave të përemrit pyetës *çish*, semantika e këtij përemri nuk është e njëjtë qoftë edhe brenda së njëjtës formë. Herë e gjejmë atë të barasvlerëshme me fjalën *çfarë*, herë me fjalën *qysh* dhe ndonjëherë me fjalën *si*. Kjo gjë dëshmon qartë jo vetëm për një përdorim të shpeshtë, por edhe të lirë të përemrit. Trajtat e tij të vjetra, *çilë, çili, çila, shdo*, kanë humbur plotësisht në të folmen e brezit të vjetër. Përemri pyetës *çfarë*, i cili nuk ekziston në dialektin e çamërishtes, nuk është i pranishëm në të folmen e brezit të vjetër. Në të rrallë tek ky brez (më shpesh tek brezi i ri) vihet re trajta e rregullt e këtij përemri, ç'ka tregon një përsosje të së folmes së tyre kah shqipës së përgjithshme; ose trajta e apokopuar *ça*, çka tregon ndërhyrjet e pashmangshme qoftë edhe në brezin e vjetër, të dialektit të tjetrit.

e. Përemrat e lartpërmendur pyetës në dialektin çam përdoren edhe me funksionin e përemrave lidhorë. Këtu përfshihen edhe trajtat e rregullta *çfarë* dhe *si*, si dhe huazimi i formës së apokopuar *ça* të së folmes tjetër. Ndërsa, përemri karakteristik lidhor i çamërishtes është përemri *që*, i cili është i njëjtë për nga forma me atë të gjuhës letrare, p.sh: *...i muarrnë vëllezër/ baballarë/ çish kishnë*

...; t'u rrojnë gjith sa ç'keni! **Çish** arrëng(aheng) do të valles ti ...; ...në Janinë e në Paramthi./ **ça...ça** zuri ai vrau //ç**i** zuri vrau/ se në luft kshu isht/ ç'të kapin vritej..etj. Këtu kemi ndonjëherë edhe shfaqje të formës së vjetër të përemrit lidhor **çil**: **çil** kapi greku i therte; apo të trajtës së tij të apokopuar **çi**: **çi** zuri vrau.

3.3. Për sa u përket numërorëve vihen re këto karakteristika:

Për numërorin 1000 (një mijë) përdoret fjala, **milë** -njëjës; **milëra** shumë. Numërorë të tjerë të rëndësishëm janë: numërori **dy**, i cili shfaqet në trajtën e tij **di**; numërori **tre**, i cili ndër të tjera është i veçantë për kategorinë e gjinisë së tij, pasi siç e dimë e gëzon këtë kategori. Për rrjedhojë kemi numërorin **tre** për gjininë mashkullore dhe numërorin **tri** për gjininë femërore, sikurse në shqipen standarde (sipas rregullave të gramatikës së shqipes së sotme). P.sh: *Di goca ke ti, a tri?.. di motra ishëm ne e një vëlla/ ëëë... tri / harrova;.. erdhën tre aroplanë.* Këto dukuri vihen re edhe për të gjithë ata numërorë që kanë në përbërjen e tyre numërorët përkatës.

Bibliografia:

- 1) Gjovalin Shkurtaç, *Si të shkruajmë* (nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale), Tiranë 2008
- 2) Gjovalin Shkurtaç, *sociolinguistika shqiptare*, SHBLU Tiranë 200
- 3) Gjovalin Shkurtaç (1995) *Nga gjeolinguistika tek dialektologjia urbane*, (Hapat e parë të sociolinguistikës në Shqipëri), në "St. Albanologjike", nr. 1.
- 4) Gaetano Berruto, *La sociolinguistica*, Bologna 1994
- 5) Richard . A. Hudson, *sociolinguistika*, (përkthyer në shqip, nga M. Ymeri), Dituria Tiranë 2002
- 6) Qemal Haxhihasani, *Vështrim për të folmen e banorëve të Çamërisë*, "Dialektologjia Shqiptare", vëll.I, Tiranë 1971, vëllimi II, Tiranë 1973
- 7) Gj. Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Kristalina-KH, Tiranë, 2004.
- 8) Eqrem Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut*, Transliteruar dhe pajisur me shënime nga Eqrem Çabej.
- 9) Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë 2001